

BULETINI JAVOR

2-6 TETOR 2023



Shprehja

"Siguria kibernetike nuk është një produkt, por një proces"

Bruce Schneier

e javës

Përmbajtja:

- Finalizohet projekti "Sinjalizues të besuar për një ekosistem kibernetik të sigurtë ndaj ekstremizmit të dhunshëm"
- Siguria Kibernetike në Sektorin e Turizmit



Finalizohet projekti "Sinjalizues të besuar për një ekosistem kibernetik të sigurtë ndaj ekstremizmit të dhunshëm"

U finalizua me sukses projekti "Sinjalizues të besuar për një ekosistem kibernetik të sigurtë ndaj ekstremizmit të dhunshëm", e organizuar nga Akademia e Studimeve Politike (ASP) në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK) me mbështetjen e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë.

Rreth 20 pjesëmarrës përfituan njohuri në ciklin e Akademisë së Sinjalizuesve të Besuar, nga ekspertët më të mirë vendas dhe të huaj. AKCESK dhe institucione të tjera shtetërore ofruan praktika dhe trajnime të dedikuara në fushën e sigurisë kibernetike.

Sinjalizuesit e besuar u bënë gjithashtu pjesë e konkursit të monitorimit të përmbajtjeve të paligjshme në internet për një periudhë 4 mujore (prill - korrik 2023), në rrjetet sociale dhe Youtube, ku sinjalizuesi me më shumë raportime iu ofrua një bursë e plotë certifikimi në Data Science, në profilin e kodimit ose sigurisë kibernetike të Academy Coding Dojo inc.

AKCESK, garantoj vijimin e mëtejshëm të formimit dhe bashkëpunimit profesional me rrjetin e Sinjalizuesve të Besuar, për të garantuar një internet më të mirë dhe më të sigurt për fëmijët dhe të rinjtë në Shqipëri

Siguria Kibernetike në Sektorin e Turizmit.

Asgjë e mirë nuk vjen nga një sulm kibernetik, prandaj është thelbësore që të jeni proaktiv, të qëndroni të informuar dhe të mbronni më mirë biznesin tuaj turistik nga kërcënimet e sigurisë kibernetike. Ndiqni disa këshilla:

1. Mos klikoni në linqe nga emaillet ose faqe interneti



2. Aktivizoni vërtetimin me dy ose me shumë faktorë (2FA/MFA)

3. Përditësoni sistemin tuaj operativ



4. Shmangni aksesimin e emailit tuaj në rrjete publike pa mbrojtjen e duhur.



BULETINI JAVOR

2-6 TETOR 2023



Shprehja

"Siguria kibernetike nuk është një produkt, por një proces"

Bruce Schneier

e javës

Përmbajtja:

- FBI paralajmëron organizatat për sulme të dyfishta ransomware
- Lyca Mobile konfirmon një sulm kibernetik
- Microsoft paralajmëron për sulme kibernetike drejt platformave Cloud
- Cisco - patching alert



FBI paralajmëron organizatat për sulme të dyfishta ransomware

FBI ka publikuar së fundmi një njoftim duke paralajmëruar organizatat e industrisë private për sulme të reja ransomware të cilat kanë si qëllim të enkriptojnë skedarët në më pak se dy ditë. Agjencia ka vëzhguar vazhdimisht këto tendenca që nga korriku 2023 dhe gjithashtu ka vërejtur se sulmuesit përdorin dy variante të dallueshme të ransomware kur synojnë organizatat, duke rezultuar në një kombinim të kriptimit të të dhënave, ekfiltrimit dhe humbjes financiare.

FBI këshillon organizatat të zbatojnë masa zbutëse dhe të raportojnë çdo aktivitet të pazakontë në rrjetet e tyre.

[Link: Lexo më shumë](#)



Lyca Mobile konfirmon një sulm kibernetik

Lyca Mobile, një operator i rrjetit virtual celular (MVNO) i cili ofron shërbime të telefonisë celulare në 60 vende dhe ka më shumë se 16 milionë klientë, ishte viktimë e një sulmi kibernetik që preku të gjitha tregjet e kompanisë, përveç atyre në Shtetet e Bashkuara, Australi, Ukrainë dhe Tunizi.

Kompania aktualisht po heton incidentin që ndërpreu rrjetin e saj dhe po përpiqet të përcaktojë shkallën e plotë të dëmit, pa konfirmuar nëse ishte një sulm ransomware.

Klientët e Lyca Mobile duhet të jenë vigjilentë dhe të monitorojnë llogaritë e tyre për çdo aktivitet të dyshimtë.

[Link: Lexo më shumë](#)



Microsoft paralajmëron për sulme kibernetike drejt platformave Cloud


Microsoft ka ofruar detaje për një fushatë të re në të cilën sulmuesit u përpoqën pa sukses të fitonin akses në një platformë cloud përmes serverave SQL të infektuar.

Sulmi nis me një injeksion SQL kundër serverit të bazës së të dhënave duke lejuar sulmuesin të mbledhë informacione rreth hostit, bazave të të dhënave dhe konfigurimit të të rrjetit.

Microsoft njoftoi se nuk gjeti asnjë provë që vërteton se sulmuesit arritën të fitojnë akses në platformën cloud.

[Link: Lexo më shumë](#)

PATCHING ALERT



Cisco - patching alert

Një javë pas rregullimit të një vulnerabiliteti të tipit zero-day, Cisco ka publikuar përditësime të reja sigurie.

Vulnerabiliteti i identifikuar si CVE-2023-20101, lejon sulmuesit e paaumentuar të aksesojnë një pajisje duke përdorur një llogari me kredenciale *default*, duke i lejuar të ekzekutojnë komanda arbitrare.

Kompania këshillon administratorët të përditësojnë instalimet e cënueshme sa më shpejt të jetë e mundur.

[Link: Lexo më shumë](#)